



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.574/2016

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari Individual Ragip Kadriu, ne çështjen juridike te paditësit: EM nga fsh. ... në ... të cilin me autorizim e përfaqëson Av.ZA nga ..., kundër te paditurës: Komuna e ..., për shkak te kompensimit te ardhurave ne emër te shpërblimit jubilar dhe kompensimin ne emër te pagave përcjellëse pas pensionimit, pas mbajtjes se seancës kryesore publike të datës 11.04.2019, me dt. 29.10.2018 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

OBLIGOHET e paditura Komuna e ..., t'ia paguajë paditësit Emin Musliu nga Mitrovicë, në emër te pagesës së 3 pagave për shpërblim jubilar pas pensionimit dhe 3 pagave përcjellëse për periudhën e punës prej 30 vite, shumën totale prej 2,801.64 €, të gjitha këto me kamat ligjore prej 8%, te gjitha ne afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit te aktgjykimit, nen kërcënimin e përmbarimit te dhunshëm

OBLIGOHET e paditura Komuna e ... t'ia paguajnë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë prej 279 Euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi me datën 14.12.2017 ka ushtruar padi për kompensimin e te ardhurave personale pas pensionimit dhe atë ne emër te shpërblimit jubilar 3 paga dhe ne emër te 3 pagave përcjellëse për ne pension.

Gjykata, me dt. 11.04.2019, ka caktuar seancë për shqyrtim kryesor, në te cilën ka prezantuar i autorizuari i paditësit, dhe përfaqësuesi i të paditurës.

I autorizuari i paditësit në seancë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi: se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së paraqitur me shkrimi propozoi gjykatës që të njëjtën ta aprovoj në tërësi si të bazuar, duke deklaruar paditësi të e paditura, është pensionuar dhe ka stazh pensional dhe kontribut dhënës me të gjatë se 30 vite dhe njëkohësisht si zjarrfikës nuk hynë në kategorinë e shërbyesve civil, andaj konsideron se janë plotësuar të gjitha

kushtet dhe kriteret e parapara me marrëveshjen e përgjithshme kolektive saktësisht neni 52 dhe 53 i kësaj marrëveshje, i njëjti heq dorë nga kamata shpenzimet i kërkon sipas Tarifës së Avokatëve.

Përfaqësuesi i të paditurës deklaron: se kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë, sepse lidhur me pozitën juridike të punëtorëve (brigada e zjarrfikësve) ka kolizion të ligjeve, ku në bazë të legjislacionit në fuqi janë tri shtylla të menaxhimit të këtyre punëtorëve, mirëpo prap se prap kompetencat janë përzgjedhur dhe në rastin konkret nuk kemi asnjë vendim gjyqësor të gjykatave themelore lidhur me këtë çështje dhe asnjë vendim të gjykatës së apelit si të veprohet në këto raste dhe kërkon që Gjykata të sjell vendim meritor lidhur me këtë çështje.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, referuar nenit 7 dhe 8 të LPK-së, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: Vendimi për përfundimin e marrëdhënies së punës ... e datës ..., Vërtetimi Nr.... i datës ..., Vërtetimi Nr.... i datës ..., Vërtetimi për përvojës e punës i datës ..., Kërkesa për pagesën e shpërblimit jubilar, pasqyrën e llogaris bankare për periudhën ...- ..., dhe pas shqyrtimit bashkërisht gjitha këtyre provave gjykata konstatoi këtë gjendje:

Nuk është kontestues fakti që paditësja ka qene në marrëdhënie pune te e paditura nga datat: ... e deri me ... , ky fakt vërtetohet në bazë të vërtetimit Nr.... të datës: ... lëshuar nga n e paditura me si dhe Vërtetimi i datës ... lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Nga vërtetimi nr. te protokollit .. të datës: ... vërtetohet se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek Komuna e në periudhën ... deri me ...

Nuk është kontestuese fakti se me datë ..., paditësi ka ushtruar kërkesë ndaj të paditurës për pagesën e shpërblimit jubilar dhe i njëjti nuk ka marrë asnjë përgjigje, kjo vërtetohet me kërkesën, e datës

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës neto që paditësi e ka realizuar nga e paditura para pensionimit është shuma mujore prej 466.94 € ku kjo vërtetohet nga gjendja e llogarisë për periudhën deri me ..., ku shihet qarte se paga ka qene ajo që përmendet me larte.

Lidhur me pretendimet e të autorizuarit të të paditurës duke e kontestuar padinë përtej lartësisë se 3 pagave përcjellëse dhe 3 page të shpërblimit jubilar, pretendim e lartcekur gjykata e refuzoj si te bazuar, duke u bazuar ne Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive, andaj për vendosje sipas pikës 1 te

dispozitivit sa i përket pagesës se tri pagave ne emër te shpërblimit jubilar iu referua nenit 52 par 1 nën par. 1.3 te Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive me te cilën parashihet se “punëmarrësi i cili për 30 vjet radhazi dhe pandërprerë te përvojës se punës te punëdhënësi i fundit t’i njihet e drejta ne shpërblim jubilar ne vlere-lartësia te tri pagave mujore te tij”, e ne rastin konkret paditësja ka qen e punësuar te e paditura për më shumë se 30 vite, ndërsa gjykata me rastin e vendosjes ne emër te kompensimit për pagesën e tri pagave përcjellëse për pension u bazua ne nenin 53 te Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive me te cilën parashihet “I punësuar, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, qe i ka marr për tre (3) muajt te fundit.

Bazuar ne nenin 52 dhe 53 te Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive është detyrim i punëdhënësit te fundit këtu te paditurës qe ti paguaj kompensimin për dy kategori te lartcekura.

Gjykata, lidhur me përlllogaritjen e kamatës, u bazua në nenin 382 par 2 të LMD-se.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve 104 euro ne emër të përpilimit të padis, për një seanc shumë të shumën prej 135 euro, taksën e padisë shumë të shumën prej 40 euro.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi ne nenin 143 par 1 te LPK-se.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

C.nr.48/2018 data 29.10.2018

GJYQTARI
Ragip Kadriu

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta ne ankese, ne afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit te të njëjtit, për Gjykatën e Apelit në Prishtine. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.